REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 28.10.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës datës 27.10.2026, të parashtruar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik "Marisa sh.p.k & Megrant ing Shpk"., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rehabilitimi i dyqaneve në Qarshinë e Madhe", Nr. i prokurimit- 632-26-7512-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-058-521, nxjerr:

V E N D I M

1. REFUZOHET SI E PABAZUAR kërkesa për rishqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik "Marisa sh.p.k & Megrant ing Shpk"., e dt. 27.10.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rehabilitimi i dyqaneve në Qarshinë e Madhe", Nr. i prokurimit- 632-26-7512-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-058-521, njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, të publikuar me datë 22.10.2026 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. VËRTETOHET njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues, i publikuar me datë: 22.10.2026, përmes të cilit është vendosur anulimi i aktivitetit të prokurimit.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Grupi i Operatorëve Ekonomik "Marisa sh.p.k & Megrant ing Shpk"., me dt.27.10.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rehabilitimi i dyqaneve në Qarshinë e Madhe", Nr. i prokurimit- 632-26-7512-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-058-521.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, më datë 28.10.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe, pas analizimit dhe vlerësimit të pretendimeve të parashtruara, ka konstatuar se:

Lidhur me pretendimin për plotësimin e Aneksit 8-Grupi i Operatorëve Ekonomikë pretendon se Aneksi 8 është plotësuar dhe nënshkruar nga të dy anëtarët e grupit përkatësisht dhe se vetëm rubrika "*Përfaqësuesi i autorizuar*" nuk është e plotësuar. Ky pretendim nuk e ndryshon faktin e konstatuar nga Autoriteti Kontraktues gjatë shqyrtimit të ofertës.

Në rastin e pjesëmarrjes në procedurë si grup i operatorëve ekonomikë, dokumentacioni i kërkuar për themelimin dhe funksionimin e grupit është pjesë përbërëse e ofertës dhe duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Neni 26.15 të ndryshim plotësimit Të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik përcakton se, kur operatorët ekonomikë marrin pjesë si grup, ata së bashku me ofertën duhet të paraqesin Marrëveshjen (deklaratë) për themelimin e grupit, në të cilën përcaktohen të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve, si dhe veprimet procedurale që duhet t'i kryejë lideri në emër të grupit.

Rrjedhimisht, nuk është e mjaftueshme vetëm ekzistenca e një dokumenti me titull "Marrëveshje për themelimin e grupit". Dokumenti duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në formularin përkatës.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se dokumenti i paraqitur në ofertë nuk është i vulosur, ndërsa kërkesa përkatëse është përcaktuar në dokumentacionin e tenderit. Për këtë arsye, konstatimi i AK-së është bërë mbi bazën e dokumentacionit konkret të dorëzuar në ofertë dhe jo mbi ndonjë kërkesë të vendosur pas dorëzimit të ofertës.

Pretendimi i Grupit të Operatorëve Ekonomikë se përmbajtja e dokumentit është e qartë nuk mund të shërbejë për ta zëvendësuar kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit. Operatorët ekonomikë janë të obliguar që ofertat e tyre t'i dorëzojnë në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara paraprakisht. Prandaj, pretendimi lidhur me Aneksin 8 refuzohet si i pabazuar.

Lidhur me pretendimin për marrëveshjen e qirasë së kamionit kiper me kran 6.5 t- Grupi i Operatorëve Ekonomikë pretendon se marrëveshja për kamionin kiper me kran me peshë bartëse maksimum 6.5 t ka ekzistuar para afatit të dorëzimit të ofertave dhe se mosparaqitja e saj në ofertë ka ardhur si pasojë e "ngatërrimit të dosjeve". Autoriteti Kontraktues e konsideron këtë pretendim të pabazuar.

Në ofertën e dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë është paraqitur lista e pajisjeve, mirëpo nuk është paraqitur marrëveshja e qirasë për kamionin konkret, e cila kërkohej për të dëshmuar të drejtën e përdorimit të pajisjes.

Kështu, ekziston një dallim i qartë ndërmjet deklarimit të posedimit/disponueshmërisë së pajisjes dhe dëshmimit dokumentar të së drejtës për përdorimin e saj.

Vetë fakti se pajisja është përfshirë në listën e pajisjeve nuk dëshmon se Grupi i Operatorëve Ekonomikë ka pasur të drejtën juridike për ta përdorur atë për realizimin e kontratës.

Për më tepër, pretendimi i Grupit të Operatorëve Ekonomikë se marrëveshja ka ekzistuar para datës 30.09.2026 nuk është i mjaftueshëm për të konstatuar përmbushjen e kërkesës.

Neni 38.3 i Rregullores përcakton se gjatë vlerësimit Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente që mungojnë në tender, por këto dokumente duhet në mënyrë objektive të paraqesin prova të mjaftueshme që pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Pra, kriteri ligjor nuk është vetëm nëse dokumenti është krijuar para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave, por nëse ai dëshmon një gjendje që ka ekzistuar para publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Për rrjedhojë, pretendimi i Grupit të Operatorëve Ekonomikë se marrëveshja është nënshkruar para datës 30.09.2026 nuk e përmbush, në vetvete, kushtin e nenit 38.3.

Nëse marrëveshja është lidhur pas publikimit të Njoftimit për Kontratë, ajo nuk mund të përdoret për të krijuar retroaktivisht një gjendje të cilën Grupi i Operatoreve Ekonomik nuk e ka dëshmuar në momentin përkatës.

Lidhur me pretendimin se Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të kërkojë marrëveshjen e munguar - Grupi i Operatorëve Ekonomikë pretendon se Autoriteti Kontraktues është dashur të kërkojë plotësimin ose sqarimin e dokumenteve, duke u mbështetur në faktin se marrëveshjet kanë ekzistuar para afatit të dorëzimit të ofertave. Ky interpretim nuk mund të pranohet në mënyrë automatike.

Neni 38 i Rregullores rregullon sqarimin e tenderëve dhe përcakton se asnjë ndryshim në çmim, kusht material ose aspekt tjetër material të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet. Në të njëjtën kohë, paragrafi 38.3 lejon marrjen e dokumenteve që mungojnë vetëm në kushtet e përcaktuara nga kjo dispozitë.

Prandaj, mekanizmi i sqarimit nuk është mekanizëm për të lejuar Grupin e Operatorëve Ekonomikë që pas afatit të dorëzimit të ofertave të krijojë ose të plotësojë një kapacitet që nuk ka ekzistuar, por shërben për verifikimin e një gjendjeje që ka ekzistuar më herët dhe që mund të dëshmohet në mënyrë objektive.

Në rastin konkret, Grupi i Operatorëve Ekonomikë nuk ka paraqitur me ofertën marrëveshjen për kamionin kiper dhe as marrëveshjen për kompresorin.

Për më tepër, vetë Grupi i Operatorëve Ekonomikë pranon se dokumentet nuk janë ngarkuar në ofertën e dorëzuar, duke e arsyetuar këtë me një gabim të brendshëm në organizimin e dokumentacionit.

Një gabim i tillë i operatorit ekonomik gjatë përgatitjes dhe ngarkimit të ofertës nuk mund t'i atribuohet Autoritetit Kontraktues dhe nuk e krijon automatikisht detyrimin e AK-së që të plotësojë dokumentacionin e munguar të ofertuesit.

Lidhur me kompresorin e ajrit për thyerje betoni - E njëjta situatë vlen edhe për kompresorin e ajrit për thyerje betoni.

Grupi i Operatorëve Ekonomikë pretendon se marrëveshja ka ekzistuar para afatit dhe se mosparaqitja e saj ka qenë rezultat i një ngatërrimi të dokumenteve. Megjithatë, në ofertën fillestare nuk është paraqitur marrëveshja përkatëse.

Kjo është me rëndësi sepse kërkesa e Autoritetit Kontraktues nuk ka qenë vetëm deklarimi i ekzistencës së pajisjes, por edhe dëshmimi i së drejtës për përdorimin e saj, sipas mënyrës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Lista e pajisjeve nuk mund të konsiderohet si zëvendësim i marrëveshjes së kërkuar, pasi këto janë dy dokumente me funksione të ndryshme: lista identifikon pajisjen e deklaruar, ndërsa marrëveshja dëshmon bazën juridike mbi të cilën Grupi i Operatorëve Ekonomikë e ka në dispozicion atë pajisje.

Prandaj, mungesa e marrëveshjes nuk është thjesht një mangësi pa rëndësi, por prek dokumentacionin me të cilin duhet të dëshmohet përmbushja e kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Lidhur me pretendimin se marrëveshjet kanë ekzistuar para afatit-Autoriteti Kontraktues vëren se Grupi i Operatorëve Ekonomikë e mbështet pretendimin kryesisht në faktin se marrëveshjet janë nënshkruar para datës 30.09.2026.

Megjithatë, kjo rrethanë duhet të analizohet në raport me datën e publikimit të Njoftimit për Kontratë, e cila është kriteri i përcaktuar në nenin 38.3 të Rregullores.

Nëse një dokument është krijuar pas publikimit të Njoftimit për Kontratë, ai nuk mund të përdoret për të dëshmuar një gjendje që ka ekzistuar para publikimit.

Për më tepër, edhe nëse dokumentet kanë ekzistuar para publikimit të Njoftimit për Kontratë, kjo nuk do të thotë automatikisht se çdo mungesë në ofertë duhet të konsiderohet e parëndësishme. Duhet të vlerësohet natyra e kërkesës, përmbajtja e dokumentit dhe nëse paraqitja e mëvonshme e tij vetëm dëshmon një gjendje ekzistuese apo në fakt plotëson një element material të ofertës.

Prandaj, pretendimi i Grupi i Operatorëve Ekonomikë nuk mund të pranohet vetëm mbi bazën e datës së pretenduar të marrëveshjeve.

Lidhur me pretendimin se oferta duhet të konsiderohet e përgjegjshme për shkak të çmimit më të ulët- Grupi i Operatorëve Ekonomikë thekson se oferta e tij në shumën prej 207,267.70 € me TVSH është më e ulët se oferta e Grupit Vetoni në shumën prej 219,914.50 €, dhe mbi këtë bazë pretendon se duhet të vazhdohet me ofertën e tij.

Ky pretendim është juridikisht i pabazuar sepse çmimi më i ulët nuk mund të kompensojë mosplotësimin e kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Në një procedurë prokurimi, fillimisht duhet të konstatohet se oferta i përmbush kërkesat administrative, teknike dhe profesionale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe vetëm pas kësaj mund të bëhet krahasimi i ofertave të përgjegjshme sipas kriterit të dhënies së kontratës.

Për rrjedhojë, një ofertë nuk mund të shpallet e përgjegjshme vetëm për shkak se ka çmim më të ulët, nëse nuk dëshmon përmbushjen e kërkesave të detyrueshme të tenderit.

Lidhur me pretendimin për anulimin e vendimit të AK-së-Duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, Autoriteti Kontraktues vlerëson se vendimi për eliminimin e ofertës së Grupit Marisa SH.P.K. dhe Megrant Ing SH.P.K. është marrë mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar në ofertë dhe në pajtim me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Grupi i Operatorëve Ekonomikë nuk ka dëshmuar se dokumentet e kërkuara janë paraqitur në ofertën fillestare, por vetëm pretendon se ato kanë ekzistuar dhe se nuk janë ngarkuar për shkak të një gabimi në organizimin e dokumenteve.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të mbajë përgjegjësi për gabimet e operatorit ekonomik në përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës.

Gjithashtu, mundësia e paraparë në nenin 38 të Rregullores për kërkimin e dokumenteve që mungojnë nuk mund të interpretohet si një e drejtë absolute e operatorit ekonomik për të plotësuar çdo mangësi pas afatit të dorëzimit të ofertave. Kjo mundësi i nënshtrohet kushteve të përcaktuara në mënyrë të qartë me këtë dispozitë, përfshirë kërkesën që dokumentet të dëshmojnë objektivisht një gjendje ekzistuese para publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Në rastin konkret, dokumentet e kërkuara nuk janë paraqitur në ofertën fillestare dhe Grupi i Operatorëve Ekonomik nuk ka dëshmuar se mosparaqitja e tyre është një mangësi që mund të korrigjohet pa cenuar kërkesat materiale të ofertës.

Lidhur me pretendimet e Grupit të Operatorëve Ekonomikë për operatorët e tjerë ekonomikë, Autoriteti Kontraktues nuk është lëshuar në shqyrtimin e detajuar të këtyre pretendimeve, për shkak se ato nuk kanë ndikim në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit për eliminimin e ofertës së kërkuesit.

Kjo për faktin se vlerësimi i përgjegjshmërisë së ofertës së Grupit të Operatorëve Ekonomikë Marisa SH.P.K. dhe Megrant Ing SH.P.K. është bërë në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga vetë kërkuesi dhe në raport me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Mospërmbushja e kërkesave të përcaktuara për ofertën e kërkuesit nuk mund të arsyetohet apo të kompensohet me pretendime lidhur me ofertat e operatorëve të tjerë ekonomikë.

Në këtë kuptim, edhe nëse do të ekzistonin pretendime lidhur me mënyrën e vlerësimit të ndonjë operatori tjetër ekonomik, një rrethanë e tillë nuk do ta ndryshonte faktin se oferta e kërkuesit nuk i ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Çdo ofertë duhet të vlerësohet individualisht, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga operatori përkatës dhe në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara paraprakisht.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk e ka konsideruar të nevojshme të zgjerohet në shqyrtimin e pretendimeve të tilla, pasi ato nuk mund të shërbejnë si bazë për ndryshimin e konstatimit lidhur me papërgjegjshmërinë e ofertës së Grupit Marisa SH.P.K. dhe Megrant Ing SH.P.K.

Megjithatë, kjo nuk nënkupton se Autoriteti Kontraktues ka paragjykuar apo anashkaluar detyrimin për vlerësimin e ofertave të tjera. Çdo ofertë është dhe duhet të jetë objekt i vlerësimit të veçantë, në pajtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

Prandaj, pretendimet e ankuesit lidhur me operatorët e tjerë ekonomikë nuk paraqesin bazë juridike për anulimin e vendimit për eliminimin e ofertës së tij dhe, si të tilla, nuk mund të ndikojnë në rezultatin e shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopje:

Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Të gjitha palëve te interesuara;

FATON GUTAJ

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e paknaqur brenda afatit prej 10 ditëve mund të paraqesë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).